



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice



Politika e Privatësisë

E drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave tuaja personale është prioritet kryesor i Akademisë së Drejtësisë, e cila angazhohet t'i përpunojë të dhënat tuaja personale me përgjegjësi dhe në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe në pajtim me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kjo politikë e mbrojtjes së të dhënave personale është e zbatueshme në rastet kur jeni aplikant për punë, palë kontraktuese, merrni pjesë në një trajnim të organizuar nga ne, vizitoni faqen zyrtare të Akademisë së Drejtësisë, përdorni ndonjë shërbim, apo paraqisni kërkesë përmes email-it ose faqes sonë të internetit.

1.Kush i përpunon dhe është përgjegjës për të dhënat tuaja personale?

Përpunues i të dhënave personale është:

- Akademia e Drejtësisë në Kosovë
- Adresa në Rr. “Murat Mehmeti” nr. 1-3 – Prishtinë
- Kontakti +383 38 200 68 000
- Posta elektronike infoad@rks-gov.net

Zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale është:

- Valmira Ahmeti – Hajdini
- Posta elektronike: valmira.ahmeti@rks-gov.net
- Numri kontaktues zyrtar: +383 (0) 38 200 68 003

2. Kategoria e të dhënave që përpunojmë

Në varësi të qëllimit të përpunimit, mund të mblidhen këto kategori të të dhënave:

- Të dhënat identifikuese: emri, mbiemri, data e lindjes, numri personal.
- Të dhënat e kontaktit: adresa e banimit, numri i telefonit, email.
- Të dhënat profesionale: pozita e punës, institucioni ku punon, kualifikimet, përvoja profesionale.

- Të dhënat e trajnimeve: pjesëmarrjet në trajnime, rezultatet, certifikatat.
- Të dhënat teknike: IP adresa dhe të dhënat e aksesit në platforma online të Akademisë.

3. Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat tuaja personale?

Të dhënat përpunohen për qëllime të tilla si:

- Organizimi dhe menaxhimi i trajnimeve dhe aktiviteteve të Akademisë.
- Administrimi i listave të pjesëmarrësve dhe lëshimi i certifikatave.
- Komunikimi dhe informimi i pjesëmarrësve.
- Përbushja e detyrimeve ligjore dhe raportuese.
- Sigurimi i qasjes në platformat online dhe ruajtja e historikut të trajnimeve.
- Përzgjedhja e punonjësve, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të specializuara dhe gjuhësore për rekrutimet e reja;
- Lidhja e kontratave dhe marrëdhënieve parakontraktuale;
- Garantimi i sigurisë së punonjësve, vizitorëve, si dhe i infrastrukturës së ndërmarrjes, përmes sistemit të mbikëqyrjes me video, sigurisë fizike, kontrollit të qasjes dhe regjistrimit të vizitorëve të jashtëm.

4. Baza ligjore për përpunim

Akademia e Drejtësisë përpunon të dhënat personale të subjekteve bazuar në Nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-082 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, dhe në përputhje me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përputhje me këtë nen, përpunimi i të dhënave bëhet mbi bazën e:

- Pëlqimit të qartë të subjektit për një ose më shumë qëllime specifike.
- Nevojës për përbushjen e një kontrate me subjektin apo për veprime përpara lidhjes së saj.
- Përbushjes së një detyrimi ligjor ndaj kontrolluesit.
- Mbrojtjes së interesave jetike të subjektit të të dhënave apo personave të tjerë fizikë.
- Kryerjes së një detyre me interes publik ose ushtrimit të një autoriteti zyrtar që i është dhënë kontrolluesit.
- Interesave legjitime të kontrolluesit ose të një pale të tretë, për sa kohë që nuk tejkalohen të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave.

Në raste të caktuara, përpunimi mund të bëhet vetëm pas pëlqimit paraprak të subjektit. Ky pëlqim mund të tërhiqet në çdo kohë, duke qenë i lehtë për t'u bërë nga vetë subjekti

5. Me kë i ndajmë të dhënat personale të mbledhura?

Të dhënat personale mund të ndahen vetëm me:

- Institucione publike të drejtësisë dhe organet e sigurisë, (nëse kërkohet ligjërisht).
- Autoritete kompetente në bazë të kërkesave ligjore.

6. Cilat janë të drejtat tuaja?

Kur të dhënat tuaja personale përpunohen nga Akademia e Drejtësisë ju keni të drejtë:

- Të qasjes në të dhënat tuaja dhe në çdo kohë, të kërkonit t'i korrigjoni dhe përditësoni pa vonesë nëse të dhënat tuaja janë të pasakta ose jo të plota;
- Të fshirjes ('e drejta për t'u harruar) së të dhënave tuaja dhe mund të kërkonit që përpunimi të ndalohet në rrethana të caktuara;
- Të kërkonit që ndonjë nga ndryshimet e mësipërme t'u komunikohet palëve të tjera, të cilave u janë zbuluar të dhënat tuaja;
- Të ankoheni në çdo kohë nëse besoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur.

7. E drejta e ankimit

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të paraqesë ankesë pranë Agjencisë për informim dhe Privatësi me adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr.22, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

8. Siguria e të dhënave personale

Akademia e Drejtësisë zbaton masat e duhura fizike, organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat tuaja personale në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave personale varet nga qëllimet e përpunimit për të cilat ato janë mbledhur dhe është e rregulluar me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

9. Përditësimi i Politikës së Privatësisë

Kjo politikë mund të ndryshohet për t'u përshtatur me ndryshimet ligjore ose organizative. Versioni më i fundit publikohet në faqen zyrtare të Akademisë së Drejtësisë.